REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2689/2 Prot. Vlorë më, 06.10.2026

VENDIM

Nr.57, datë 06.10.2026

PËR

RIALOKIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2026–2027, NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 38 dhe të nenit 69, pika 3 të të ligjit Nr.80/2015"*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", ", të Urdhërit të Përbashkët nr.108, datë 15.06.2026 *"Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2026-2027;* nenit 19, pika 1, gërma f të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 61, pika 3 dhe 4 të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; si dhe referuar relacionit të Sektorit të Kurrikulave dhe Statistikave, përcjellë me shkresën me nr.2690/2 prot., datë 06.10.10.2026, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.10.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë rialokimin e kuotave të pranimit në programet e ciklit të parë të studimeve, për vitin akademik 2026–2027, sipas propozimit të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, si më poshtë:

Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore

a) Të rialokohen 6 (gjashtë) kuota nga kategoria "Degë e dytë" dhe 3 (tre) kuota nga kategoria "Transferime" në kategorinë "Shqiptarë brenda vendit", në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike.
b) Të rialokohen 2 (dy) kuota nga programi i studimit Bachelor në Matematikë-Fizikë, nga të cilat 1 (një) kuotë nga kategoria "Program i dytë studimi" dhe 1 (një) kuotë nga kategoria "Transferim

studimesh", në kategorinë "Shqiptarë brenda vendit", në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike.
c) Të rialokohen 2 (dy) kuota nga kategoria "dega e dytë", 2 (dy) kuota nga kategoria "Transferim studimesh", 1 (një) kuotë nga kategoria "Shtetas të huaj" dhe 1 (një) kuotë nga kategoria "Statusi i jetimit"dhe 1(një)kuotë nga kategoria "Romë, Ballkano Egjiptian), në kategorinë "Kuota brenda vendit", në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Navale.

2. Rialokimet e miratuara me këtë vendim nuk ndryshojnë numrin e përgjithshëm të kuotave të miratuara për programet e ciklit të dytë të studimeve, sipas Vendimit të Senatit Akademik nr. 22, datë 30.04.2026 "Për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në të gjitha ciklet e studimit për vitin akademik 2026-2027".
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe strukturat përgjegjëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Bashkëlidhur tabela e kuotave për programet e studimit të sipërcituara.
5. Ky vendim përcillet në Ministrinë e Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Aurela Saliaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË

Nr.	*Njësia Kryesore*	*Programi I Studimit*	*Cikli I Studimit*	*TOTAL KUOTA 2026-2027*	*Shqiptarë Brenda vendit*	*Që aplikojnë për Program II*	*Që aplikojnë për Transferim studimesh*	*Shtetas me diplomë të huaj*	*Me statusin e jetimit*	*Persona me aftësi të kufizuar*	*Romë + ballkano egjiptiane*	*Kosovë*	*Maqedoni*	*Mal i Zi*	*Preshevë*	*Bujanovë*	*Medvegje*	*Total troje*
1	FSHTN	Inxhinieri Mekanike	Bachelor	**76**	**51**	1	4	20	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	FSHTN	Inxhinieri Navale	Bachelor	20	20	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	FSHTN	Matematikë -Fizike	Bachelor	12	10	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0